

**SKEMA E VLERËSIMIT TË PROVIMIT PROFESIONAL NGA GJUHA  
SHQIPE DHE LETËRSIA, QERSHOR 2017**

1. Është rrethuar numri 2. kanë frikë nga gjithçka që është e panjohur dhe ndryshe. - 1 pikë
  
2. Nxënësi/nxënësja\* merr **1 pikë** nëse shkruan: *Vilemina*
  
3. Nxënësi merr **1 pikë** nëse rrethon JO dhe shkruan: Vinsenti është piktor/artist i mirë, por dëshiron të vizatojë sa më bukur, kërkon të jetë i përkryer (dhe përgjigje të tjera të sakta)  

(Vërejtje: nxënësi merr një pikë nëse nuk e ka rrethuar përgjigjen PO, por ka dhënë arsyetimin e saktë.  
Nëse ka rrethuar PO, por nuk ka dhënë arsyetimin e saktë ose nuk e ka shkruar fare arsyetimin merr – 0 pikë)
  
4. Është rrethuar numri 2. Nuk kam sukses, sepse vizatoj ashtu siç i përjetoj unë gjërat. - 1 pikë
  
5. A) Është rrethuar numri 1 – kënaqësinë. - 1 pikë  
B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse përshkruan ose perifrazon tekstin: *“Po në qoftë se ai person ndihet i lumtur falë atij arti të keq?”* (dhe përgjigje tjera të sakta)
  
6. Është rrethuar numri 2 – habi. - 1 pikë
  
7. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *“Arti nuk respekton rregulla, kërkon të bukurën, lirinë artistike; teologjia kërkon respektimin e rregullave të ashpra, kërkon pagabueshmërinë... (dhe përgjigje tjera të sakta)*
  
- Po të jetë përgjigjja e plotë dhe stilistikisht e realizuar nxënësi merr 2 pikë.*
  
8. Është rrethuar numri 3 - *Donte të dinte kush ishte ai njeri që nuk kishte ardhur për t'i uruar sukses para nisjes në luftë.* - 1 pikë
  
9. Është rrethuar numri 2 – indiferencë dhe krenari - 1 pikë
  
10. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *“Aleksandri dëshiron të tregojë se e vlerëson Diogjenin dhe qëndrimin e tij/ Aleksandri tregon respekt për Diogjenin dhe të drejtën e tij që të mos i përkulet me çdo kusht vullnetit të dikujt tjetër “ (dhe përgjigje tjera të sakta)*

11. Është rrethuar numri 3 – Lëvizja letrare “bejtexhi”. - 1 pikë

12. **A)** Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan se: poeti përdor shumë fjalë orientale (turke, arabe, persiane)

**B)** Nxënësi merr 1 pikë nëse shkruan: Hasan Zyko Kamberi në shkrimet e veta ka përdorë alfabetin arab. - 1 pikë

13. **A)** Nxënësi merr **1 pikë** nëse numëron së paku dy forma letrare që paraqiten në poezinë e bejtexhinjve: divani, gazeli, kasidja, jahilia, rubaira...

**B)** Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan se risia tematike që ky autor sjell në letërsinë shqipe, (e që vihet re edhe në poezinë e dhënë si shembull), është tematika laike (jofetare).

14. Nxënësi merr **1 pikë** nëse e rrethon përgjigjen P (PASAKTË) dhe shkruan: Në baladën popullore ROZAFATI vetëm vëllai i vogël e mban besën që lidhën të tre vëllezërit, për të mos u treguar bashkëshorteve vendimin që kanë marrë. Dy vëllezërit e tjerë e shkelin besën e dhënë.

**(Vërejtje:**

Nxënësi merr një pikë nëse nuk e ka rrethuar përgjigjen P (PASAKTË), por e ka arsyetuar saktë përgjigjen.

Nëse nxënësi e ka rrethuar përgjigjen P (PASAKTË), por nuk e ka arsyetuar saktë përgjigjen, ose nuk e ka shkruar fare arsyetimin, merr 0 pikë.

15. Nxënësi e merr **1 pikë** nëse numëron së paku dy tipa të baladës që shfaqen në letërsinë popullore: balada e murimit, balada e ringjalljes (ose e vëllait të vdekur), balada e rinjohjes, balada e besës.

16. Nxënësi merr **3 pikë** për shpjegimin e plotë të vargjeve të cituara.

**3 pikë** Lidhja e besës në mes të vëllezërve dhe mostregimi i planit të murosjes së njërës nga gratë dhe mosshembja e kalasë për shkak të flijimit (*dhe përgjigje tjera të ngjashme*)

**2 pikë** Lidhja e besës në mes të vëllezërve dhe mostregimi i panit të murosjes

**1 pikë** Lidhja e besës në mes të vëllezërve

**0 pikë** nëse nxënësi ka dhënë përgjigje të gabuar ose nuk ka dhënë asnjë përgjigjeje

17. A) Kanconieri - **1 pikë**  
B) Epokës së Renesancës - **1 pikë**
18. A) Sonet (tingëllimë) - **1 pikë**  
B) Antitezën (ose kontrastin) - **1 pikë**
19. A) Mënyra urdhërore - **1 pikë**  
B) E pakryera - **1 pikë**
20. Është rrethuar numri 1. epike - **1 pikë**
21. A) Ekzistencializmi (absurdi) - **1 pikë**  
B) Në azil portieri kishte hyrë nga nevoja (dhe përgjigje tjera të sakta) - **1 pikë**

C) Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan:

Narratorit i bënte përshtypje mënyra se si ai thoshte “ata”, “të tjerët” dhe më rrallë “pleqtë”, kur fliste për pleqtë e azilit disa, prej të cilëve nuk ishin më të moshuar se ai.

22. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan :

Mërsoi është një person tepër gjakftohtë, të cilit asgjë, pra as vdekja e nënës, nuk i bën përshtypje, dhe refuzimi i tij për ta parë nënën e vdekur në arkivol është në përputhje me karakterin e tij, gjakftohtë deri në indiferencë. (dhe përgjigje tjera të sakta)

*Po të jetë përgjigjja e plotë dhe stilistikisht e realizuar nxënësi merr **2 pikë**.*

23. Nxënësi merr **2 pikë** nëse jep përgjigje plotësisht të saktë:

1. Hamleti
2. Raskolnikovi
3. Adham-Uti

Nxënësi merr 1 pikë për dy përgjigje të sakta.

Nxënësi merr 0 pikë për një përgjigje të saktë.

24. Nxënësi merr – **1 pikë** nëse ka dhënë përgjigje plotësisht të saktë.

- i tyre - rasa gjinore.  
qytetit - rasa dhanore  
një krusmë – rasa emërore

**25.** Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan:

Në sallën solemne të Qendrës Kulturore Informative “Malësia” në Tuz, mbrëmë u organizua prezantimi i librit “Komunikojmë dhe hartojmë përdorimin e gjuhës” të autorit Bahri Beci.

**26. A)** Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka dhënë përgjigje plotësisht të saktë:

zhvesh ; shpik ; (i, e) lezetshëm

**B)** Nxënësi merr – **1 pikë** nëse ka dhënë përgjigje plotësisht të saktë:

Revolucioni intelektual i Iluminizmit u pasua nga revolucionet politike në Francë dhe Amerikë si dhe nga rebelimi i lëvizjeve kombëtare anembanë Evropës.

**27.** Nxënësi merr **2 pikë** për katër përgjigje të sakta (shkrimin e saktë të titullit të veprës emrin dhe mbiemrin e autorit të saj:

1. Beatricja - Komedia hyjnore (Ferri), Dante Aligieri
2. Vlladika Danillo – Kurora e maleve, Petar II Petroviq Njegosh
3. Kreonti - Antigona, Sofokliu
4. Zonja Johansson - Enciklopedia e të vdekurve, Danillo Kish

Nxënësi merr **1 pikë** për tri përgjigje të sakta.

Nxënësi merr **0 pikë** për një ose dy përgjigje të sakta.

**28. A)** Nxënësi ka rrethuar përgjigjen pranë numrit 4 – letërsia popullore si frymëzim - **1 pikë**

**B)** Sqarimi pranë numrit katër është veçori e romantizmit, tri sqarimet e tjera kanë të bëjnë me realizmin. – **1 pikë**

**29.** Nxënësi merr **1 pikë** nëse i ka dhënë të gjitha përgjigjet e sakta:

Hektori – tarogzëtundësi

Akili – këmbëshpejti

Andromaka - krahëbardha

### 30. Skema për vlerësimin e letrës formale

Përmbajtja	Saktësia gjuhësore	Forma grafike e tekstit
<p>Nxënësi merr <b>4 pikë</b> nëse në bazë të reklamës së dhënë ka shkruar elementet themelore të letrës:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-kreu - adresanti / dërguesi, adresa</li> <li>-adresati/ marrësi, adresa</li> <li>-vendi dhe data e hartimit të letrës</li> <li>-Përshëndetja hyrëse</li> <li>-teksti i letrës (me 3 arsye pse i drejtohet kompanisë)</li> <li>-përshëndetja përfundimtare</li> <li>-nënshkrimi</li> </ul>	<p>respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore, kongruencës, përdorimi i gjuhës standarde</p> <p><b>2 pikë</b></p> <p>respektimi i normës drejtshkrimore (shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit, respektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores <b>ë</b>)</p>	<p>Nxënësi merr <b>2 pikë</b> nëse: organizimi i përgjithshëm dhe forma grafike e letrës formale i është përshtatur strukturës logjike të tij</p> <p>- Në fletë lart, te kreu, shkruhen të dhënat themelore të dërguesit, pastaj vijnë të dhënat e marrësit, nën të dhënat e marrësit shënohet emri i vendit dhe data kur është hartuar letra; teksti i letrës me përshëndetjen hyrëse: i/e nderuar; përshëndetja përfundimtare : me respekt, përshëndetje të përzemërta; në fund nënshkrimi).</p>
	<p><b>2 pikë</b></p> <p><b>Gjithsej 4 pikë</b></p>	<p>Nxënësi merr <b>1 pikë</b> nëse i ka shkruar të gjithë elementet e letrës, por të dhënat e marrësit (emrin, mbiemrin, adresën) dhe vendin e datën e hartimit të letrës në vend që t'i shkruajë në fletë lart (në fillim), i ka shkruar në fund të letrës.</p>
	<p>respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet që kanë të bëjnë me përdorimin semantik të parafjalëve <b>për</b> dhe <b>mbi</b>, përemrit <b>i vet/ i tij</b>, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit</p>	<p>Nxënësi merr <b>0 pikë</b> nëse elementet themelore të letrës nuk ia ka përshtatur strukturës së saj grafike.</p>

	<p><b>lidhur me këtë, duke marrë parasysh</b> dhe i përemrave: <b>që, i cili, e cila, të cilët</b> etj.)</p> <p><b>1 pikë</b></p> <p>respektimi i normës drejtshkimore me gabime të pakta ( p.sh. ndonjë mospërdorim i drejtë i shenjave të pikësimit, mosrespektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, mospërdorimi i drejtë i zanores <b>ë</b>)</p>	
<p>Nxënësi merr <b>3 pikë</b> nëse, në bazë të reklamës së dhënë, ka shkruar me stil:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-kreu - adresanti / dërguesi, adresa</li> <li>-adresati / marrësi, adresa</li> <li>-data e hartimit të letrës</li> <li>-përshëndetja hyrëse</li> <li>-teksti i letrës (me 2 arsye pse i drejtohet kompanisë)</li> <li>-përshëndetja përfundimtare</li> <li>-nënshkrimi</li> </ul>	<p><b>1 pikë</b></p> <p><b>Gjithsej 2 pikë</b></p>	
<p>Nxënësi merr <b>2 pikë</b> nëse, në bazë të reklamës së dhënë, ka shkruar me stil:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-kreu - adresanti / dërguesi,</li> <li>-adresati/marrësi,</li> <li>-data e hartimit të</li> </ul>		

<p>letrës -përshëndetja hyrëse -teksti i letrës (me 2 arsye pse i drejtohet kompanisë) -përshëndetja përfundimtare -nënshkrimi</p>		
<p>Nxënësi merr <b>1 pikë</b> nëse, në bazë të reklamës së dhënë, ka shkruar me stil: -kreu - adresanti / dërguesi, -adresati/marrësi, -teksti i letrës (me 2 arsye pse i drejtohet kompanisë) -përshëndetja përfundimtare</p>		

Nxënësi merr

**0 pikë** nëse:

-ka shkruar letrën  
pa adresantin dhe  
adresën

- teksti i letrës është  
shkruar paqartë dhe  
pa stil,

- ka shënuar  
adresantin,  
adresatin, por në  
tekst ka dhënë

vetëm 1 arsye pse i  
drejtohet

kompanisë

- letra nuk ka lidhje  
me reklamën e  
dhënë

-teksti i shkruar nuk  
është letër...